

# DITARI MUJOR DHJETOR 2024



## BUXHETI 2025: RITJJE PËR INOVACIONIN DHE TRASHËGIMINË

Buxheti i ri për Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit kap vlerën 56 miliardë lekë dhe sjell rritje në sektorë kyç:

- 15% më shumë për sigurimet shoqërore;
- 18% rritje për arsimin profesional;
- 60% rritje për inovacionin.

Kjo përbën një vizion të qartë për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, ruajtjen e trashëgimisë dhe nxitjen e teknologjisë, duke siguruar një të ardhme të fortë për Shqipërinë.

## 'K'cimi i Tropojës' në UNESCO



"K'cimi i Tropojës" është shpallur pjesë e Listës Përfaqësuese të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit nga UNESCO. Vendimi u mor gjatë sesionit të 19-të të Komitetit Ndërqeveritar për Ruajtjen e Trashëgimisë Jomateriale, në Paraguaj. Kjo njohje ndërkombëtare shënon një moment historik për kulturën tonë kombëtare, duke afirmuar rëndësinë e ruajtjes së traditave tona dhe pasqyrimin e identitetit tonë në botë. Ritmet e veçanta dhe emocionet që "K'cimi i Tropojës" sjell tani janë një thesar global i njerëzimit.

## BONUSI I FUNDVITIT PËR PENSIONISTËT: NJË FESTË ME SOLIDARITET

Mbi 570,000 pensionistë kanë tërhequr bonusin e fundvitit.

15,000 lekë për pensionet nën 20,000 lekë, invalidët dhe pensionet familjare (13,712 përfitues);

10,000 lekë për pensionet mbi 20,000 lekë (5,854 përfitues).

Bonusi mund të tërhiqet deri më 30 qershor 2025 në çdo pikë të Postës Shqiptare ose Banka të Nivelit të Dytë.



## HAP HISTORIK I SHQIPËRISË DREJT INTEGRIMIT NË BE

Në Konferencën e Tretë Ndërqeveritare mes Shqipërisë dhe BE-së, vendi ynë çeli negociatat për Grupkapitullin VI, që përfshin marrëdhëniet me jashtë dhe politikën e sigurisë.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit udhëheq negociatat për 10 kapituj dhe kontribuon në 5 të tjerë, duke dëshmuar përkushtimin e vendit për të përmbushur kriteret e anëtarësimit dhe për të realizuar ambicien europiane të Shqipërisë.



## SHQIPËRIA DREJT STANDARDEVE BOTËRORE NË MIKPRITJE: PARTNERITET ME EHL

Shqipëria ka nisur një hap të rëndësishëm drejt transformimit të arsimit profesional në industrinë e turizmit dhe mikpritjes, falë bashkëpunimit me Ecole hôtelière de Lausanne (EHL), shkolla më e mirë në botë për këtë sektor. Në ambientet e shkollës “Hoteleri-Turizëm” në Tiranë, tashmë zbatohet Programi VET by EHL, i cili



sjell certifikim të dyfishtë për nxënësit dhe një platformë globale trajnimesh sipas standardeve ndërkombëtare, duke e çuar Shqipërinë një hap më pranë tregut global të mikpritjes.

## PAKETA E MALEVE: NJË VIZION PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT MALOR

Zëvendësministri Sokol Duma prezantoi vizionin e “Paketës së Maleve” në një dëgjese publike mbi turizmin rural dhe malor. Objektivi kryesor është zhvillimi i turizmit malor gjatë gjithë vitit, rivitalizimi i zonave malore dhe zgjidhja e çështjeve të pronësisë.


Kjo nismë premtan mbështetje për komunitetet lokale dhe tërheqjen e investimeve të diasporës, duke nxjerrë në pah rëndësinë e maleve si një burim i pashtershëm për zhvillim ekonomik dhe social.



## INAUGUROHET TEATRI I KUKULLAVE

Pas një rikonstrukcioni të plotë me mbështetjen e programit EU-4Culture dhe Delegacionit të BE, Teatri i Kukullave ka rifituar shkëlqimin e tij origjinal.

Restaurimi i fasadës, çatisë dhe elementeve autentike nga vitet 1920-1930, së bashku me teknologjitë moderne të skenës, e bëjnë teatrin një investim të rëndësishëm për krijimtarinë dhe edukimin kulturor të fëmijëve dhe të rinjve shqiptarë.



### REKORD VIZITORËSH NË SITET KULTURORE

Shqipëria ka regjistruar 1,289,506 vizitorë në sitet kulturore nga janari nëntor 2024, një rritje prej 32% krahasuar me një vit më parë. Destinacionet më të vizituara përfshijnë:

- Kalaja e Gjirokastrës (260,290 vizitorë);
- Parku Kombëtar i Butrintit (199,198 vizitorë);
- Muzeu i Krujës (170,405 vizitorë).

Ky sukses pasqyron përkushtimin për ruajtjen e trashëgimisë dhe promovimin e saj si një motor zhvillimi turistik dhe ekonomik.





### RISIA E OBP: PLATFORMA QË TRANSFORMON PROKURIMET PUBLIKE

Përmes regjistrimit të mbi 100 operatorëve ekonomikë në platformën e saj online, OBP ka rritur pjesëmarrjen dhe transparencën në proceset e prokurimeve publike. Njoftimet automatike për tenderët dhe aksesimi në kohë reale i informacioneve kanë sjellë efikasitet për të gjitha palët e interesuara.

Kjo qasje moderne përforcon angazhimin për një administratë më të hapur dhe efikase.

## SHQIPËRIA DHE KOSOVA: NJË HAP I PËRBASHKËT DREJT LOJËRAVE MESDHETARE 2030



Në një akt simbolik që përforcon bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve tona, Kryeministrat Edi Rama dhe Albin Kurti nënshkruan marrëveshjen historike për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030. Eventu i madh sportiv do të zhvillohet në Prishtinë, ndërsa Durrësi do të jetë një ndër qytetet mikpritëse, duke demonstruar fuqinë e bashkimit. Marrëveshja është një hap i rëndësishëm për promovimin e sportit dhe mikpritjes shqiptare në arenën ndërkombëtare.

## QENDRA E RE KULTURORE PËR FËMIJË: INVESTIMI QË FRYMËZON BREZAT E RINJ

Një ndërtesë moderne në zemër të Tiranës po merr formë për t'u kthyer në një pikë referimi për artin dhe kulturën e fëmijëve.

Me hapësira multifunktionale dhe një dizajn inovativ, qendra ofron edukim përmes artit dhe shfaqjeve kulturore.

Skena e re, me kapacitet të shtuar dhe fleksibilitet të lartë, do të mundësojë organizimin e aktiviteteve lokale dhe ndërkombëtare, duke forcuar rolin e artit në jetën e fëmijëve dhe të rinjve shqiptarë.



## INVESTIMET E HUAJA DIREKTE ARRIJNË REKORD HISTORIK

Për 9-mujorin e parë të vitit 2024, Shqipëria regjistroi një fluks rekord të Investimeve të Huaja Direkte (IHD), që arriti në €1.16 miliard, me një rritje 5% krahasuar me vitin e kaluar.

Turqia kryeson me 17.6% të investimeve, e ndjekur nga Italia dhe Holanda.

Sektorët kryesorë:

- Pasuritë e paluajtshme (23.2%)
- Financat dhe sigurimet (17.8%)
- Energjetika (11.2%)

Këto shifra tregojnë interesin e lartë të investitorëve ndërkombëtarë dhe përpjekjet e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve për të promovuar Shqipërinë si destinacion ekonomik të qëndrueshëm.



## DITËT KULTURORE SHQIPTARE NË BOTË: NJË URË LIDHËSE ME DIASPORËN

Gjatë një takimi të veçantë me Këshillin Koordinues të Diasporës, u prezantua programi “Ditët Kulturore Shqiptare në Botë,” i cili synon forcimin e lidhjeve të diasporës me atdheun përmes artit dhe kulturës.

Aktivitetet artistike dhe nismat inovative pritet të promovojnë identitetin tonë kombëtar, ndërkohë që zgjerimi i mundësive për investime dhe krijimi i një rrjeti global shqiptar janë prioritetet e vizionit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për të ardhmen.



## MUZEU KOMBËTAR I ARTEVE TË BUKURA: TRANSFORMIM DHE MODERNIZIM

Punimet për zgjerimin dhe modernizimin e Muzeut Kombëtar të Arteve të Bukura po vazhdojnë me ritme të shpejta.

Projektet kryesore përfshijnë:

- Dyfishim i hapësirave ekspozuese dhe restaurim i avancuar.
- Përmirësim i aksesit dhe sigurisë për thesaret artistike.
- Pajisje me sisteme moderne klimatike për ruajtjen e veprave.

Ky transformim pritet të shndërrojë muzeun në një qendër bashkëkohore të artit dhe kulturës, duke e vendosur Shqipërinë në hartën ndërkombëtare të muzeve.



## KONKURSI “NOVELAT GRAFIKE SHQIPTARE”, SHPALLEN FITUESIT

Edicioni i 8-të i konkursit “Novelat Grafike Shqiptare” mblodhi 26 pjesëmarrës, prej të cilëve u shpërndanë pesë çmime kryesore:

Rei Kërçova fitoi çmimin e parë për fabulën filozofike dhe mesazhin optimist.

Gert Simoni u vlerësua për trajtimin grafik të figurës së Skënderbeut.

Melisa Koyun doli e treta për ndjeshmërinë poetike dhe detajet piktorale.



## MOZAIKU I TIRANËS, HAP SË SHPEJTI DYERT PËR PUBLIKUN

Punimet për restaurimin dhe transformimin e Mozaikut të Tiranës kanë përfunduar, duke ofruar një hapësirë unike për të parë mozaikët e antikitetit shqiptar.

Ky projekt unik do të sjellë më pranë qytetarëve dhe turistëve mozaikët e mbyllur të periudhës së antikitetit dhe antikitetit të vonë, të ruajtur në sitet tona më të rëndësishme si Apollonia, Butrinti, Bylis, Durrësi, Elbasani, dhe shumë të tjera.



## KREDI TË SUBVENCIONUARA PËR FAMILJET SHQIPTARE

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka hapur aplikimet për kredi të subvencionuara me interes vetëm 3% në vit për familjet e reja, gratë kryefamiljare dhe grupet e tjera në nevojë.

Me synimin për të përmirësuar jetën e 2,000 familjeve në 26 bashki, ky program është një shembull i angazhimit të qeverisë për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbështetjen sociale.

## NJOHJA E PUNËS PARA VITIT 1994 PËR PENSIONET

Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), miratoi projektligjin që njeh periudhat e punës para vitit 1994 në institucione shtetërore, ish-ndërmarrje dhe kooperativa bujqësore për efekt pensioni.

Ky projekt pritet të përfitojë 40,000 individë çdo vit duke filluar nga 2025.

Ky vendim sjell lehtësime për mijëra qytetarë që kanë pritur me vite për të realizuar të drejtën e tyre për pension.



## NGA 2025 DËRGESAT E PARAVE NGA EUROPA E ANASJELLTAS PA KOSTO FINANCIARE

Nga 1 Janari i vitit 2025 dërgesat e parave nga Europa e anasjelltas nuk do të kenë asnjë kosto financiare. Shqipëria u bë pjesë e sistemit unik evropian të pagesave gjatë muajit Nëntor dhe ky vendim është një tjetër hap i madh në rrugën drejt Shqipërisë 2030 në Bashkimin Evropian.

Po ashtu kjo sjell edhe miliona euro të kursyera nga detyrimet mbi dërgesat.



## MEKI PJESË E TAKIMIN TË PLATFORMËS SË TREGTISË E INVESTIMEVE TË UNIONIT PËR MESDHEUN

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, përfaqësuar nga Zëvendësministrja znj. Blerta Rama, mori pjesë në takim të 8-të Rajonal të Platformës së Tregtisë dhe Investimeve të Unionit për Mesdheun, i cili u mbajt në Bruksel. Nën drejtimin e Komisionit Evropian, në këtë takim u diskutuan çështje të lidhura me tregtinë, si rregullat e origjinës preferenciale në kuadër të Konventës Rajonale PEM, të cilat Shqipëria i ka miratuar dhe po punohet edhe për miratimin e dispozitave tranzitore për vazhdimësinë e lehtësimit të tregtisë me partnerët tregtarë. Një fokus i rëndësishëm i takimit ishin edhe zhvillimet në kuadër të negociatave në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) për dy marrëveshje të reja, ajo për Lehtësimin e Investimeve dhe Zhvillimin dhe për Tregtinë Elektronike.



## GJIROKASTËR: RESTAURIME PËR TË RUAJTUR TRASHËGIMINË KULTURORE

Në Gjirokastrë po realizohet një nga ndërhyrjet më të mëdha në trashëgiminë kulturore, me një fokus të veçantë në ruajtjen e monumenteve historike. Aktualisht po punohet në:

- Restaurimin e urave të Mesit, Kollorcës, Glinës, Haskovës dhe murit perëndimor të Banesës Fico.
- Ndërhyrje emergjente për Urën mbi Përroin e Benjës.

Projekte të tjera të rëndësishme do të nisin së shpejti, si restaurimi i Kishës së Manastirit të Shën Mërisë në Spile, Sarajeve të Myfit Beut në Libohovë dhe Kishës së Manastirit të Shpërftyrimit.

Ky angazhim rrit atraktivitetin turistik dhe kontribuon në zhvillimin ekonomik të zonës, duke mbrojtur historinë dhe vlerat kombëtare për brezat e ardhshëm.



## VIJOJNË PUNIMET PËR TEATRIN KOMBËTAR

Puna për ndërtimin e Teatrit Kombëtar në Tiranë po ecën me ritme të larta. Projekti, i konceptuar nga arkitektët e Bjarke Ingels Group, përfshin hapësira moderne për artistët dhe publikun.

Deri më tani, janë përfunduar punimet për mbrojtjen e themeleve dhe një pjesë e strukturës kryesore. Ky teatër do të ofrojë përvoja gjithëpërfshirëse dhe do të jetë një pikë referimi për artin skenik.



## INVESTIMET NË STREHIMIN SOCIAL: NJË JETË MË E MIRË PËR FAMILJET NË NEVOJË

Programi i Investimeve të Strehimit Social po transformon jetën e 847 familjeve në 22 bashki të Shqipërisë. Ky projekt jo vetëm që siguron strehim të sigurt, por krijon edhe hapësira ku familjet mund të ndërtojnë të ardhmen me dinjitet.

Duke adresuar nevojat sociale emergjente, ky angazhim shënon një hap të madh drejt një modeli të drejtë dhe gjithëpërfshirës të zhvillimit shoqëror, duke kontribuar në një të ardhme më të ndritur për vendin tonë.



## SAMITI I 8-TË PËR INTELIGJENCËN ARTIFICIALE DHE EKONOMINË NË STAMBOLL

Në Samitin e 8-të për Inteligjencën Artificiale dhe Ekonominë në Stamboll, Shqipëria u përfaqësua nga Zëvendësministrja Blerta Rama. Ky event shërbeu si një platformë për të ndarë vizionet mbi të ardhmen teknologjike dhe ekonomike.

Pjesëmarrja shqiptare theksoi rëndësinë e inovacionit dhe përfshirjes në trendet globale teknologjike, duke hapur horizonte të reja për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.



## GOVTECH: TEKNOLOGJIA NË SHËRBIM TË QYTETARËVE

Konferenca ndërkombëtare "Formësimi i së Ardhmes së GovTech" në Tiranë mbledhi liderë rajonalë për të diskutuar sfidat dhe mundësitë në ndërthurjen e teknologjisë dhe qeverisjes.

Synimi kryesor është ndërtimi i një infrastrukture dixhitale për lehtësimin e jetës së qytetarëve dhe nxitjen e investimeve. Shqipëria po forcon pozitat si një lider rajonal në inovacionin qeverisës.



## KËSHILLI KONSULTATIV I NDËRMARRJEVE: NJË HAP I RI PËR NMV-TË

Lançimi i Këshillit Konsultativ të Ndërmarrjeve shënon një etapë të rëndësishme për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Shqipëri.

Ky organ ofron një platformë për dialog mes sektorit publik dhe atij privat, duke ndihmuar në hartimin e politikave që mbështesin rritjen e NMV-ve.

Angazhimi i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për krijimin e një mjedisi të favorshëm për bizneset është dëshmia e qartë e rëndësisë së këtij sektori për ekonominë shqiptare.





## INVESTITORËT TURQ NË SHQIPËRI: NJË PARTNERITET ME POTENCIAL TË MADH EKONOMIK

Shqipëria mirëpriti një grup investitorësh nga Turqia për të diskutuar mundësitë e bashkëpunimit dhe zhvillimit. Në këtë takim, theksi u vu te potencialet e turizmit, ekoturizmit dhe inovacionit. Shqipëria po shndërrohet në një qendër tërheqëse për investitorët falë klimës së favorshme ekonomike dhe politikave lehtësuese fiskale, duke dëshmuar se vendi ka shumë për të ofruar në sektorët me rritje të shpejtë dhe inovacion.



## MIRATIMI I RREGULLAVE TË REJA PAN-EURO-MEDITERIANE PËR ORIGJINËN

Bruksel, Shqipëria votoi për miratimin e rregullave të reja për origjinën preferenciale pan-Euro-Mediterrane. Vendimet e miratuara parashikojnë përdorimin e certifikatave elektronike dhe dispozita kalimtare që sigurojnë mbajtjen e përfitimeve tarifore aktuale deri në hyrjen në fuqi të rregullave të reja. Këto ndryshime janë një hap i rëndësishëm për të mbështetur bizneset shqiptare dhe lidhjet e tyre me tregjet rajonale dhe europiane.



## MBAHET DËGJESA PUBLIKE PËR MUZEUN BESA

Projekti për restaurimin e ish-banesës së Toptanasve/Libohovitëve në Tiranë synon shndërrimin e saj në “Muzeun Besa,” një hapësirë kulturore që do të pasqyrojë një nga vlerat më të mëdha të identitetit shqiptar.

Përmes konsultimeve me ekspertët dhe përfshirjes së komunitetit, projekti do të promovojë ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe pasurimin e narrativave historike, duke krijuar një lidhje mes traditës dhe bashkëkohësisë.



## OBP: REVOLUCIONI I PROKURIMEVE PUBLIKE NË SHQIPËRI

Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka shënuar një transformim historik në sistemin e prokurimeve publike brenda vetëm tetë muajsh nga themelimi. Me platformën online ALBZONE dhe katalogun digjital, është garantuar transparencë dhe efikasitet në proceset e tenderimit. OBP ka fituar vlerësime nga partnerët europianë dhe synon të forcojë më tej tregun e lirë shqiptar duke rritur cilësinë dhe standardet e shërbimeve të ofruara.



## PROGRAMI KOMBËTAR I STREHIMIT SOCIAL: HAPEN APLIKIMET PËR BASHKITË

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka hapur aplikimet për projektet e strehimit social, që përfshijnë banesa sociale, përmirësim infrastrukture dhe streha të përkohshme për komunitetet më të pafavorizuara.

Bashkitë e vendit kanë afat deri në fund të janarit për të dorëzuar dokumentacionin.

Ky program synon të ndryshojë jetën e atyre që kanë më shumë nevojë, duke ofruar zgjidhje konkrete dhe humane.

**HAPET THIRRJA PËR PROJEKTET E INVESTIMEVE NË KUADËR TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË STREHIMIT SOCIAL**

- Banesa sociale me qira (blerje, adaptim ose ndërtim i ri)
- Përmirësim i infrastrukturës në zona informale
- Përmirësim i banesave për komunitete të pafavorizuara
- Streha të përkohshme (blerje, montim ose adaptim objekteve ekzistuese)

**AFATI I APLIKIMIT: 31 JANAR 2025**